

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Ministri Demo në Rinas me Policinë Kufitare: Mirënjohje për përballimin efikas të fluksit rekord të udhëtarëve
ADRESA	https://www.gazetatema.net/sociale/92-milione-turiste-ne-tete-muaj-fluks-rekord-ne-rinas-demo-alenderon-pol-i587233
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 10:10:47 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 10:10:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c6a0ec15e28475110d1dbb81bd39d54675bd6c4d9bb93d5dad5c73b033d8b2be
TEKSTI	86e11e43e0f0bcc912f317a63f57d53b59e20118b2fb4a6e4bcbe5b65c2f0214
PAMJA	77a5d132cf2309fac2af436afdeded72a197a9c23b56e43f9da9226940fc07c5

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	02b632bfd6bac4f325cdca41f976b2c492212b3d9cdd6277860a2756799e9a83
E MËPARSHMJA	9469914a3a374bee20b0749c6da64e62cfb2eae4a10d52ac9b88878d488be288
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/02b632bfd6bac4f325cdca41f976b2c492212b3d9cdd6277860a2756799e9a83

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)

English

Detaje nga atentati ne Sarande/ Viktima tentoi te largohej sapo pa autoret! U qellua ne mes te rrugesNe kerkim nga Gjermania per trahk droge, kapet ne Morine 34-vjeça fundit

Ministri Demo në Rinas me Policinë Kufitare: Mirënjohje për përballimin efikas të fluksit rekord të udhëtarëve



20 Shtator 2026, 12:10Sociale TEMA



Ministri i Punëve të Brendshme, Ervin Demo, vizitoi sot punonjësit e Policisë Kufitare në Aeroportin Ndërkombëtar "Nënë Tereza", në kalimin verior të kufirit në Rinas, për t'i falenderuar për angazhimin dhe përkushtimin gjatë një sezoni turistik me flukse të jashtëzakonshme udhëtarësh. Takimi u zhvillua së bashku me Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Skënder Hita, si një vlerësim për punën e strukturave që çdo ditë përballojnë hyrje-daljet në pikën kryesore kufitare ajrore të vendit, duke garantuar njëkohësisht shërbim të shpejtë, siguri dhe kontroll kufitar.

Vetëm gjatë muajve të verës, Policia Kufitare në Rinas ka punuar me ngarkesë të shtuar për të përballuar flukse që kanë arritur në dhjetëra mijëra pasagjerë në ditë. Muaji gusht raportonte afro 55 mijë pasagjerëve në ditë dhe kalimin e shërbimeve kufitare në regjim 12-orësh gjatë sezonit turistik.

Duke iu drejtuar efektivëve, ministri Demo u shpreh se kontakti i parë që shumë vizitorë kanë me Shqipërinë është pikërisht me punonjësit e Policisë Kufitare.

"Ju jeni fytyra e parë që udhëtarët shohin kur mbërrijnë për vendin tonë dhe marrëdhënia që ne krijojmë me këdo që futet në kufi, qytetarë vendas e të huaj, është siguria që duam të përçojmë", u shpreh ministri.

Ministri Demo falenderoi punonjësit e Policisë për profesionalizmin me të cilin kanë përballuar rritjen e ndjeshme të flukseve gjatë sezonit turistik, duke nënvizuar se rezultatet e arritura janë mbi të gjitha rezultat i punës së njerëzve në terren.

"Çdo gjë nis me punonjësin e Policisë, sjellja e të cilëve duhet të jetë një model qytetarie që duhet të shtrihet tek të gjitha shërbimet duke nisur nga pikat kufitare."- shprehet ministri Demo.

Gjatë takimit u evidentua edhe përdorimi gjithnjë e më i madh i teknologjisë në përpunimin e udhëtarëve dhe në përmirësimin e shërbimit.

Përtej uniformave policore, përmirësimi i shërbimeve evidentohet edhe përmes përdorimit të teknologjisë, modernizimin e sistemeve dhe pajisjeve të kontrollit kufitar dhe sistemit e-Gate, që kanë mundësuar shkurtimin e kohës së përpunimit dhe menaxhimin më efikas të flukseve.

Ministri i Brendshëm përmendi se teknologjia do të vijojë të jetë një instrument i rëndësishëm, por nuk zëvendëson rolin e punonjësit të Policisë, - "Ne do

punojmë fort që ta shtrijmë përdorimin e teknologjisë në të gjitha shërbimet, jo thjesht kufitare, për të rritur efikasitetin, për të garantuar sigurinë publike dhe për të krijuar një eksperiencë të re referimi për qytetarin në territorin e Shqipërisë”.

Gjithashtu, Demo theksoi se rritja e numrit të udhëtarëve kërkon që shteti të vazhdojë të investojë paralelisht në kapacitete njerëzore, teknologji dhe kushte më të mira pune, në mënyrë që shërbimi ndaj qytetarëve të bëhet më i shpejtë pa cenuar standardet e sigurisë. sezonit të ardhshëm turistik dhe nevojën për të vlerësuar forcimin e kapaciteteve të Komisarariatit të Rinasit.

“Së bashku me drejtorin, ne po shohim mundësinë që të përgatitemi edhe më mirë për sezonin e festave dhe sezonin tjetër turistik, duke përforcuar Komisariatin e Rinasit, për të përballuar fluksin e turistëve që tashmë Shqipëria pret”, thotë Ministri Demo referuar nevojës për forcimin e burimeve njerëzore.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Tregu i punës përmirësohet, por hendeku gjinor mbetet i lartë: Vetëm gjysma e grave janë të punësuar](#)

10:10 Sociale

[Frenohet "vrulli" i TEMU - AKEP: Dërgesat ndërkombëtare bien me 52% në Shqipëri, pas bumit të porosive online gjatë 2025](#)

16:45 Sociale

26 efektivë të Forcave të Armatosura nisin kursin 3-mujor profesional me fokus terminologjinë tekniko-ushtarake

15:45 Sociale

[Nafta fik traktorët, fermeri habitet nga çmimi: Po e blejmë njësoj si makinat luksoze](#)

14:25 Sociale / 4 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.